

Bashkim Aliji, PhD<sup>1</sup>

UDC:  
323.12:28-051(4-627.EU)

## **ISLAMOFOBIA SI SFIDË E INTEGRIMIT TË MYSLIMANËVE NË UE**

### **ИСЛАМОФОБИЈАТА КАКО ПРЕДИЗВИК НА ИНТЕГРАЦИЈАТА НА МУСЛИМАНИТЕ ВО ЕУ**

### **ISLAMOFOBIA AS A CHALLENGE OF INTEGRATION OF MUSLIMS IN THE EU**

#### **Abstract**

In this paper, Islamophobia is treated as a challenge in the path of integration of the Muslim community, as the largest religious community in Europe and in the European Union.

In this paper it is concluded that Islamophobia is present in Europe in general and in EU countries, in particular, based on many reports of various European human rights centers and organizations and the fight against xenophobia and racism.

This paper concludes that Islamophobia is not a product of only one factor, but several factors, and as more pronounced have been identified the following factors: Historical Conflicts; High birth rate of foreigners; Global War on Terrorism; Middle East War Zones; Bloody images from warlords in some Muslim majority countries.

In this paper it is concluded that Islamophobia, though present in Europe, can be overcome and deserves not to be a reason of fear of Islam and Muslims by Western society, and cannot be a decisive factor in building the attitude against the integration of Muslims in Europe.

---

<sup>1</sup> Doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim, ligjërues në Universitetin e parë privat FON – Shkup.

Key words: Islamophobia, integration, human rights, multiculturalism, Muslim community, European Union.

## **HYRJE**

Integrimet evropiane paraqesin një nga kapitujt më karakteristikë më të njohur dhe më të theksuar të demokracisë dhe vlerave evropiane të shekullit XX dhe XXI. Procesi i integritit u promovua nga ana e UE-së si model më i suksesshëm për demokraci të vërtetë dhe mbrojtje të të drejtave të njeriut, që gjeneroi nga vetëdija për unitet për të arritur objektiva të rëndësishme, të përbashkëta, të cilat do të rezultojnë aksione kolektive efikase në fusha të ndryshme dhe politika unike që do të realizojnë mirëqenie për të gjithë individët dhe bashkësitë, me status të njëjtë, si qytetarë të një shoqërie të përbashkët progresive.

Në kontekst të integritimeve evropiane, i një rëndësie të posaçme është integrimi i bashkësive të ndryshme etnike, religjioze dhe kulturore, në shoqëritë evropiane, me theks të veçantë, bashkësisë myslimane, si një nga bashkësitë religjioze minoritare më të mëdha brenda vendeve të UE-së. Por, në këtë kontekst, temë boshte janë edhe sfidat me të cilat ballafaqohet bashkësia myslimane në rrugën e integritit të saj në UE. Me këtë rast, Islamofobia është detektuar si një nga sfidat më serioze në rrugën e integritit të myslimanëve në UE dhe është dukuri shoqërore serioze dhe problem real në Evropë. Nisur nga kjo, është mjaft e rëndësishme të shqyrtohet islamofobia si sfidë e integritit të muslimanëve në UE.

## **PËRKUFIZIMI I INTEGRIMIT**

Sipas një definicioni më të thjeshtë, integrimi paraqet lidhje institucionale në mes dy dhe më tepër bashkësive të ndryshme në një shoqëri. Sipas Majkëll Hoxhis (Michael Hodges), integrimi është “krijimi i sistemeve të reja politike, nga ato sisteme të cilat deri më tash kanë qenë të ndara nëpër shtete” (Hodges, 1972: 13). Në informimin e publikuar të Komisionit për agjendën e përgjithshme për integrim, integrimi definohet si proces dykahësh, i cili i ngarkon me detyra të caktuara të dy palët: edhe shtetet ku ka individë dhe bashkësi nga vendet e tjera, po ashtu edhe vetë individët dhe bashkësitë të cilët kanë ardhur në atë shtet (shih: Nikolloski, 2010: 90-91).

## ISLAMOFOBIA SI SFIDË

### *Përkufizimi i Islamofobisë*

Islamofobia, si nocion, ka lindur në Evropë, dhe supozohet se ka filluar të përdoret diku në vitin 1925, ndërkaq sipas disa të tjerëve, ky term është përdorur për herë të parë në vitin 1921 në librin *L'orient vu de de l'occident* (Lindja në këndvështrimin e Perëndimit) të autorëve Etienne Dinet dhe Sulejman ibën Ibrahim. Por, me siguri se kjo dukuri ka qenë prezente edhe para kësaj kohe (Moncef Marzouki, 2007:284).

Për Islamofobinë nuk ka një definicion të pranuar unanimisht, edhe pse, në përgjithësi, renditet në suaza të dukurive ksenofobike, racizmit dhe diskriminimit racor, të cilat dukuri janë të definuara sipas standardeve ndërkombëtare.

Në një publikim të Këshillit të Evropës për islamofobinë, islamofobia shihet si “frikë nga Islami, ose paragjykime ndaj Islamit, myslimanëve dhe çështjeve që kanë të bëjnë me ta. Pa marrë parasysh a shprehet në formë të racizmit dhe diskriminimit apo më tepër si formë e dhunës, islamofobia është lëndim i të drejtave të njeriut dhe paraqet kërcënim për kohezionin shoqëror” (Islamophobia and its consequences on Young People, 2005: 6).

Në raportin e organizatës joqeveritare britaneze *the Runnymede Trust*, islamofobia është cilësuar me karakteristikat vijuese:

- Islami shihet si një bllok monolit, statik dhe i ftohtë, indiferent ndaj realiteteve të reja;

- Islami shihet si i ndryshëm nga tjerët, e jo si pjesë e atyre që kanë vlera të përbashkëta me kulturat e tjera, që nuk janë të përshkuar nga këto vlera dhe që nuk kanë ndikim në to;

- Islami shihet si inferior, barbar, irracional, primitiv në raport me perëndimin dhe shihet si diskriminues i gjinive;

- Islami shihet si dhunues, agresiv, kërcënues, mbështetës i terrorizmit dhe i angazhuar në përplasjen e civilizimeve;

- Islami shihet si ideologji politike, e cila shfrytëzohet për qëllime politike ose luftarake.

- Kritikata e Islamit ndaj “Perëndimit”, refuzohen si të pavlefshme.

- Armiqësia ndaj Islamit, shfrytëzohet që të arsyetohen praktikata diskriminuese ndaj myslimanëve dhe përjashtimin e myslimanëve nga rrjedhat kyçe të shoqërisë;

- Armiqësia ndaj myslimanëve është pranuar si e natyrshme dhe normale (Islamophobia a challenge for us all, 1997: 3).

Disa studiues dhe juristë të të drejtave të njeriut, islamofobinë e definojnë si shprehje e armiqësisë dhe frikës prej Islamit në kuadër të stereotipave që bazohen në premisa të mishëruara në kulturën evropiane dhe shenjtërimi i tyre ma tepër se vetë fetë: Premisa e parë është: lidhja e pandarë ndërmjet Islamit dhe dhunës; e dyta: kundërshtimi parimor ndërmjet Islamit dhe demokracisë; e treta: armiqësia e hapur ndërmjet Islamit dhe laicizmit (Hejthem Menna', 2007:168).

Mendimtari bashkëkohor musliman Xhafer Shejh Idris, islamofobinë e përkufizon si akuzë kundër Islamit, e që sipas tij manifestohet në qëndrim armiqësor ndaj fesë islame (Xhafer Shejh Idris, 2011:133).

### *Shkaqet e Islamofobisë*

Islamofobia është prezente në Evropë dhe në perëndim në përgjithësi, për çka flasin edhe shumë raporte të qendrave dhe organizatave të ndryshme për të drejtat e njeriut dhe luftimin e ksenofobisë dhe racizmit, dhe për këtë ka disa shkaqe. Islamofobia nuk është produkt vetëm i një faktori, por lindjen e saj kanë ndikuar disa faktorë. Sipas pikëpamjes sonë, shkaqet më të theksuara që kanë çuar në paraqitjen e islamofobisë në shoqërinë evropiane, janë si vijon:

1. Konfliktet historike: Marrëdhëniet myslimane-krishtere gjatë historisë janë shënuar nga një mori konfrontimesh të cilat kanë ndodhur ndërmjet këtyre dy palëve, dhe me këtë rast, si më të theksuara janë konfrontimet vijuese:

- a. Luftërat e kryqëzatave të cilat u udhëhoqën nga të krishterët perëndimorë në tokën e shenjtë të Kudsit (Jerusalemit);
- b. Sundimi pesë shekullor i shtetit Osman në një pjesë të Evropës;
- c. Prezenca shtatë shekullore arabe-islame në Gadishullin Iberik (Spanjë).

Edhe përkaj se këto konfrontime i takojnë së kaluarës historike, shumë lehtë mund të keqpërdoren nga ana e lëvizjeve ekstreme në Evropë për ta nxitur disponimin antimusliman te një pjesë e caktuar e euro-perëndimorëve dhe të krijojnë klimë frike nga Islami dhe myslimanët. Këto ngjarje paraqesin nxitës potencialë të urrejtjes kundër të huajve, ndërkaq në Evropë, të huajt janë kryesisht myslimanë. Këtë e shënon edhe intelektual gjerman Murad Hofman, i cili thekson se rrethimi i Vjenës nga ana e turqve, ende është e gjallë në memorien e evropianëve dhe nxit frikë, urrejtje dhe panik (Hofmann, 2007: 74-75).

2. Nataliteti i lartë i të huajve. Nuk është jo e zakonshme që nataliteti i lartë i të huajve, në veçanti myslimanëve, të cilët jetojnë në vendet evropiane, në krahasim me popullatën autoktone të Evropës, të instrumentalizohet nga ana e rrymave djathtiste antimigrante në Evropë dhe të shndërrohet në nxitëse të frikës prej myslimanëve. Këto rryma natalitetin e lartë të myslimanëve e vënë në kontekst kulturor dhe strategjik, duke e shndërruar në një plan strategjik të myslimanëve që numerikisht të sundojnë në Evropë për disa dekada, dhe në përgjithësi, myslimanët e diasporës, i shohin si “pionierë” të ushtrisë pushtuese myslimane, e cila ka për qëllim të vënë pushtet islam global (Bjorgo, 1997: 60).

3. Lufta globale kundër terrorizmit. Lufta globale kundër terrorizmit, e cila fitoi në intensitet pas sulmeve në Nju Jork dhe Uashington D.C., më 11 shtator të vitit 2001, pati ndikim në rritjen e islamofobisë, për atë se personat të cilët u identifikuan si përgjegjës për sulmet dhe bartës të këtyre sulmeve, ishin myslimanë. Sulmet e 11 shtatorit të vitit 2001 në dy qytetet amerikane, reflektuan edhe në nxitjen e debatit religjioz mes përpiluesve të draftkushtetutës së Evropës (Reka, 2007:165).

4. Vatrat e luftës në Lindjen e Mesme. Konflikti disadekadësh arabo-izraelit në Palestinë, pastaj intervenimi ushtarak në Irak në vitin 2003, si dhe kaosi që pasoi në Irak, pas këtij intervenimi, po ashtu janë nxitës potencialë të islamofobisë në Perëndim. Kjo, ngase sulmet kamikaze me bomba në disa vende evropiane, nga ekzekutorët e tyre u cilësuan si hakmarrje ndaj involvimit të disa shteteve perëndimore në këto konflikte, qoftë indirekt, si në rastin e konfliktit izraelito-palestinez dhe izraelito-arab apo drejtpërdrejt, siç është rasti me Irakun, për të cilin akuzohen perëndimorët se janë përgjegjës për kaosin që pasoi në këtë vend.

Nga ana tjetër, këto sulme, qoftë në Evropë, fjala vjen si rasti i sulmeve në Madrid, Londër, Berlin, Bruksel etj., apo ndaj caqeve ushtarake në vatrat e krizës në Lindjen e Mesme, nga qarqe ekstreme, u panë si tregues të fuqishëm të dëshirës së myslimanëve për hakmarrje ndaj të gjitha padrejtësive që Perëndimi i bën në vendet islame (Jasch, 2007:04, 346; Archick, 2005: 11).

5. Pamjet e përgjakshme nga vatrat e luftës në disa vende me shumicë myslimane. Pamjet të cilat për çdo ditë emetohen dhe janë lajme kryesore në mediumet perëndimore, si dhe qarkullojnë me të madhe në rrjetet sociale, pa dyshim, krijojnë pasqyrë negative për myslimanët

në kokën e “njeriut perëndimor”, gjegjësisht krijohet përshtypja se Islami, për nga natyra e vet, është religjion i dhunës dhe është i lidhur me luftën. Për rrjedhojë, krijohet përshtypja se njerëzit fetar, në veçanti, janë njerëz të dhunës, jotolerancës, urrejtjes dhe jo të emancipuar. Ky gjykim i krijuar nga tele-kultura, në ndikim negativ në ndërtimin e raporteve të perëndimorëve me myslimanët praktikues të religjionit.

Së këtejmi, nisur nga konstatimi se Islamofobia është prezente në Evropë, si dhe duke u thirrur në shkaqet e përmendura, dhe në shumë tjera të cilat nuk janë zënë në gojë, arrihet në përfundimin se Islamofobia paraqet një faktor potencial për të krijuar hendeqe ndërmjet shoqërisë perëndimore dhe bashkësisë myslimane, si dhe për rrjedhojë, nëse nuk do të mund ta ndalojë në tërësi, me siguri se do ta sfidojë integritimin e myslimanëve në vendet e UE-së, dhe në Evropë në përgjithësi.

#### *Tejkalimi i sfidës*

Edhe pse islamofobia është prezente në Evropë dhe në perëndim në përgjithësi, për çka flasin edhe shumë raporte të qendrave dhe organizatave të ndryshme për të drejtat e njeriut dhe luftimin e ksenofobisë dhe racizmit, kjo dukuri nuk meriton të jetë shkak për krijimin e frikës nga Islami dhe nga muslimanët, nga ana e shoqërisë perëndimore, si dhe nuk mund të jetë deçizive në ndërtimin e qëndrimit kundër integritimit nga ana e myslimanëve në Evropë.

Evropa bashkëkohore është promotore e multikulturalizmit dhe respektimit të përcaktimeve të njerëzve, qoftë se bëhet fjalë për përcaktimin religjioz apo përcaktimet e tjera. Për rrjedhojë, përkatësisë fetare dhe ikjes nga përmendja e Islamit, për Evropën e sotme është i papranueshëm dhe jocompatibil me vlerat evropiane, dhe është vetëm një iluzion të pretendosh se fshehja e të gjitha llojeve të përkatësive, duhet bërë në emër të evitimit të luftërave fetare, nga të cilat Evropa ka vuajtur me shekuj (Ramadan, 2003: 146).

Ndërkaq, kur është në pyetje Unioni Evropian si organizatë, atëherë është shumë lehtë të identifikohet përcaktimi i kësaj organizate në luftë kundër ksenofobisë dhe racizmit, si dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke u thirrur në politikat e saj të cilat janë transparente dhe të qarta.

Për më tepër, UE-ja, me qëllim të ruajtjes së kohezionit shoqëror brenda shoqërive evropiane, ka miratuar disa dokumente relevante. Sa për ilustrim do ta përmendim Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore. Të gjitha vendet anëtare,

obligohen t'i respektojnë dispozitat e kësaj konvente. Po ashtu, çdo shtet i cili aderon të jetë anëtar i UE-së, duhet t'i plotësojë disa kushte, mes tjerash edhe kushtet vijuese: a) respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut; b) trajtim të barabartë të gjithë qytetarëve; c) mosdiskriminim në baza etnike, racore dhe religjioze.

Një element tjetër thelbësor që paraqet mbështetje serioze për tejkalimin e sfidës së Islamofobisë si pengesë të integritit, është funksionimi i shtetit ligjor në të gjitha vendet e UE-së dhe mosdiskriminimi në baza fetare i qytetarëve para ligjit. Shtetet evropiane janë shtete të së drejtës ku sundon ligji dhe garantojnë të drejta të barabarta para ligjit për të gjithë qytetarët, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare dhe etnike. Për këtë, çdo mysliman, si qytetar i UE-së, ka të drejtë të plotë t'u drejtohet organeve gjyqësore në çdo shtet të UE-së, nëse mendon se ndonjë vendim është i padrejtë dhe ka simptome të islamofobisë.

#### *Prezenca e myslimanëve vs Islamofobisë*

Islami dhe myslimanët janë realitet në Evropë qoftë se bëhet fjalë për myslimanët të cilët kanë ardhur në Evropë përmes rrugëve legale, me lejen e vetë organeve oficiale evropiane, si fuqi punëtore, që realisht Evropës i janë vënë në shërbim kur ka pasur nevojë më së tepërmi, gjegjësisht pas Luftës së Dytë botërore apo bëhet fjalë për myslimanët evropianë, të cilët janë konvertuar në Islam. Myslimanët e konvertuar janë banorë autoktonë të Evropës, nuk janë të shpërngulur në Evropë nga ndonjë kontinent tjetër dhe ky trend është në rritje në Evropë. Për atë, myslimanët e sotëm në Evropë, nuk mundet të shihen me ato sy që janë parë më herët. Në këtë kontekst, Murad Hofman, nënvizon se prezenca e sotme e myslimanëve, në veçanti e turqve në Gjermani, Austri dhe në vendet tjera euro-perëndimore, nuk duhet të shihet me sytë e kohës së sundimit të Perandorisë Otomane, kur kontrollonin pjesë të Evropës. Sot, turqit kanë ardhur në Vjenë, Kreuzberg, Berlin dhe në qytete tjera, jo me forcën e shpatës, por në mënyrë të ndershme dhe legale, me viza pune të cilat i kanë marrë në konzulatat në Stamboll, Ankara, Izmir (Hofmann, 2007: 74).

Në Evropën e sotme kemi edhe një realitet tjetër, kur janë në pyetje myslimanët, gjë që determinon edhe pranimin e tyre si qytetarë me të drejta të plota, si të gjithë qytetarët e tjerë, pa paragjykime dhe frikë. Fjala është për gjeneratat e reja të myslimanëve të cilët janë lindur në Evropë, e që rrjedhin prej prindërve të ardhur në vendet e UE-së nga vende të tjera të Evropës apo të ndonjë kontinenti tjetër dhe nuk kanë

shtetësi tjetër, pos asaj të ndonjë shteti evropian dhe vendlindja e tyre është Evropa. Pra, myslimanët janë pjesë e shoqërisë evropiane.

Në fakt, UE-ja e ka pranuar këtë realitet dhe punon në drejtim të forcimit të prezencës së myslimanëve si bashkësi më e madhe religjioze në UE. Në këtë drejtim, vendet e UE-së kanë ndërmarrë disa iniciativa, me target të veçantë komunitetin mysliman, me qëllim që të promovohet integrimi dhe politika e kohezionit shoqëror, përfshi këtu edhe iniciativat të cilat i referohen drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte, luftimit të islamofobisë (shih: European Monitoring Center on Racism and Xenophobia, 2006: 93-98).

*Angazhimi i bashkësisë myslimane në tejkalimin e sfidës së Islamofobisë*

Bashkësia myslimane, si komunitet minoritar religjioz më i madh në Evropë, duhet të angazhohet më seriozisht dhe duhet të bëjë më tepër, për ta ç'rrënjësuar islamofobinë në Evropë, edhe atë:

**a-Duke e luftuar çdo veprim të jashtëligjshëm dhe elementet destruktive brenda bashkësisë myslimane në Evropë.**

Shumë veprime të jashtëligjshme në Evropë, krahas elementeve të tjera, kanë edhe një prezencë të dukshme të personave të cilët i takojnë bashkësisë myslimane. Nuk është e panjohur se një numër i madh i të burgosurve në vendet evropiane janë pjesëtarë të komunitetit mysliman (Roy, 2004: 79). Kjo dukuri, edhe pse nuk i fajëson mbarë myslimanët si komunitet, dhe as që i bën përgjegjës myslimanët për shkeljet ligjore të disa individëve të cilët i takojnë bashkësisë së tyre, krijon një dozë të frikës nga këta njerëz, tek evropianët e zakonshëm, ndërkaq rrymat ekstremiste shumë lehtë mund ta përdorin këtë element për të propaganduar Islamofobi, me pretekst se këta njerëz kanë qëllim që të hakmerren kundër Perëndimit, dhe këto veprime janë rezultat i urrejtjes së tyre ndaj evropianëve.

Së këtejmi, myslimanët duhet të jenë të vendosur dhe aktiv në luftën kundër elementeve të këtylla destruktive dhe veprimeve të jashtëligjshme. Kjo, nga njëra anë që ta tregojnë përcaktimin e tyre si bashkësi kundër veprimeve të jashtëligjshme, pa marrë parasysh kush është kryerës i tyre, dhe për faktin se elementi mysliman, në gjithë këtë, është i theksuar. Këtu duhet të theksohet roli i xhamive dhe i institucioneve të tjera islame, gjegjësisht liderëve fetarë të myslimanëve në Perëndim, të cilët duhet të punojnë edhe më tepër në drejtim të edukimit të gjeneratave të reja në frymën e së mirës dhe luftës kundër së keqes dhe



destruktives, pa marrë parasysh ku jetojnë, dhe pa marrë parasysh cilit komunitet i takojnë.

b-Duke qenë të vëmendshëm në cilësimin e veprimeve si islamofobike.

Edhe përkaj faktit se Islamofobia është prezente në Perëndim në përgjithësi, si dhe brenda shteteve të UE-së, në veçanti, kjo nuk do të thotë se çdo veprim që merret kundër ndonjë myslimani është i natyrës islamofobike. Kjo konsiston në atë se myslimanët duhet të jenë të vëmendshëm gjatë kualifikimit të një vepre si islamofobike, si dhe duhet të përmbahen nga cilësimi i menjëhershëm i rasteve të ndryshme si islamofobike.

Me këtë rast, duhet pasur parasysh se, disa veprime, të cilat bëhen kundër disa muslimanëve nga ana e disa evropianëve, nuk është patjetër që të mbajnë vulën e Islamofobisë, por duhet shikuar nga këndi i natyrës së shoqërisë evropiane, ku dominon logjika e interesit dhe përfitimit. Këtë do ta ilustruim me shembullin vijues:

❖ Punësimi i femrës myslimane në disa veprimtari: Kështu, disa herë, femra myslimane që mban mbulesë islame mund të hasë në probleme gjatë punësimit në ndonjë kompani, gjegjësisht të refuzohet për ndonjë vend pune, pikërisht për shkak se mban mbulesë islame. Megjithatë, ky vendim, nuk do të thotë se është rezultat i islamofobisë, por është rezultat i mentalitetit të tregut, gjegjësisht është rezultat i asaj se punëdhënësi e ka parasysh vetëm atë se cila grua është më atraktive për ndonjë punë të caktuar dhe e cila mund të tërheqë më tepër klientë, e jo ajo se çfarë përkatësie fetare ka kandidati për një vend pune. Kjo do të thotë se nëse një myslimane e cila nuk mban mbulesë sipas rregullave të fesë konkurron për një vend pune, mund të pranohet në punë.

Qasja e këtillë objektive ndaj dukurive të këtilla është normale se do të ndikonte pozitivisht në tejkalimin e kësaj sfide, si dhe do ta shtonte respektin e ndërsjellë dhe konsideratën e evropianëve ndaj bashkësisë myslimane. Për më tepër, do të ishte një shtytje e fuqishme për forcat progresive në Evropë, që edhe më tepër të kontribuojnë në promovimin e bashkësisë muslimane si element konstruktiv në ndërtimin e Evropës si shoqëri kohezive, progresive dhe stabile. Me një përcaktim të këtillë, myslimanët do t'i delegjitojnë dyshimet te disa qarqe evropiane përkitazi me lojalitetin e myslimanëve ndaj shoqërive evropiane dhe përkatësinë e tyre qytetare, për të cilën Tarik Ramadan thotë: “Kjo gjendje e vetëdijes, duket se është e rrënjosur thellë në shumë vende perëndimore, në veçanti në regjionet ku myslimanët janë në numër të

madh dhe ku ekziston problemi i papunësisë” (Ramadan, 1999: 217). Qëndrimi i këtillë konstruktiv dhe përkushtimi i qartë i myslimanëve për shoqëritë ku jetojnë, do të kontribuojnë për qëndrim më real të Perëndimit ndaj myslimanëve dhe islamofobisë si dukuri.

## RECOMMENDATIONS

Islamophobia is present in Europe and the West in general, and represents one of the most serious challenges in the path of Muslim integration in the EU. However, it can be overcome and deserves not to be a reason of fear of Islam and Muslims by the Western society and it cannot be a decisive factor in building the attitude against the integration of Muslims in Europe. To overcome this phenomenon, some measures should be taken, and in this paper we recommend the following:

- Effective functioning of committees for combating racism and xenophobia, and transforming these commissions into important parts of the legislative system in EU countries.

- Building relationships between religious communities and Western societies on the basis of trust and mutual respect, far from prejudice and mistrust.

- Greater engagement of the Muslim community with concrete projects and activities that would result in the correction of erroneous judgments for the Muslim community as a result of media propaganda on the one hand, and the lack of reliable information for this community and the inactivity of this community in the public life of European societies, on the other hand.

- Prudence and carefulness in assessing certain non-constructive actions against Muslims, such as Islamophobic actions.

- The functioning of the rule of law for instigators of interfaith hatred.

- Opening dialogue with the various parties in society to address the problem of Islamophobia.

- The proper presence in the media and in public life for the leaders of the Muslim communities to show the attitude of Islam towards various issues and events concerning the communities.

- Greater engagement of Islamic organizations for dialogue with various parties.

- Organize roundtables, debates, seminars, symposiums, etc., to explore racist and xenophobic phenomena, with emphasis on Islamophobia.
- Governments support for projects of Muslim community and other minority cultural communities, aimed at promoting intercultural dialogue and serving multiculturalism.

**Recensentë:**

**Prof. dr. Nazmi Maliqi**

**Prof. dr. Zunun Zununi**

**LITERATURA**

Archick, Kristina. 2005. "The European Union: Europe's Muslim Communities and Islamist Extremism". *Muslims in Europe: Integration Policies in Selected Countries*. CRS Report for Congress.

[www.investigativeproject.org/documents/testimony/332.pdf](http://www.investigativeproject.org/documents/testimony/332.pdf)

---. 2005. "The United Kingdom Britain's Muslim Community and Islamist Extremists". *Muslims in Europe: Integration Policies in Selected Countries*. CRS Report for Congress.

[www.investigativeproject.org/documents/testimony/332.pdf](http://www.investigativeproject.org/documents/testimony/332.pdf)

Beck, Ulrich и Grande, Edgar. 2006. *Kozmopolitska Europa*. Zagreb:Skoljska knjiga.

Bjorgo, Tore. 1997. "The invaders", "the traitors" and "the resistance movement": the extreme right's conceptualisation of opponents and self in Scandinavia', in: T. Modood and P. Werbner (Eds), *The Politics of Multiculturalism in the New Europe: Racism, Identity and Community*. London: Zed Books.

EUMC. 2006. *Muslims in the European Union-Diskrimination and Islamophobia*. Vienna.

Hodges, Michael. (ed). 1972. 'Introduktion', in *European Integration*. London: Penguin.

Hofmann, Murad. 2007. *Islami në mijëvjeçarin e tretë*. Shkup: Furkan ISM.

Hofmann, Murad. 2000. *Islami si alternativë*. Shkup: Furkan ISM.

Jazexhi, Olsi. 2008. "Përdorimi politik i islamofobisë në Shqipërinë paskomuniste", në: *Integrimi i shqiptarëve në Evropë dhe*

vlerat që Islami përçjell në këtë integritim. Kavajë: Forumi Musliman i Shqipërisë.

Idris, Xhafer Shejh. 2011. *Islami në shekullin tonë*. Përktheu: Një grup përkthyesish. Shkup: NUN.

*Islamophobia a challenge for us all.*

Извop:<http://www.runnymedetrust.org/uploads/publications/pdfs/islamophobia.pdf>

Nikolloski, Zlatko. 2010. Migracii: Kontradikcii ili priçina za pozitivni efekti. Shkup: Botim privat.

Manna, Haytham. 2009. "Islamophobic act as Human Rights Issue", në: International Conference on Islamophobia, Istanbul (2007): The Union of NGOs of the Islamic World.

Marzouki, Moncef. 2009. "Fundamental Questions About dhe Concept iof Islamophobia", në: International Conference on Islamophobia, Istanbul (2007): The Union of NGOs of the Islamic World.

Ramadan, Tariq. 2003. *Western Muslims and the Future of Islam*. Oxford University Press.

Ramadan, Tariq. 1999. *To be a European Muslim*. Leicester: The Islamic Foundation.

Reka, Blerim. 2010. *Gjeopolitika dhe teknika e zgjerimit të UE-së*. Bruksel: ASPECT.

---. 2007. *Kushtetuta e UE Rubikoni i Supranacionales*. Shkup: Logos-A.

Roy, Olivier. 2004. *Globalizimi i Islamit*. Tiranë: IDK.

Runnymede Trust. 2000. *The Future of Multi-Ethnic Britain*. London: Runnymede Trust.